

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT
TË KONKURRENCËS PËR VITIN 2011

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se:

Veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës është ushtruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ndryshuar me ligjin nr. 9499, datë 3.4.2006.

Kuvendi vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës në drejtim të:

- Rritjes dhe konsolidimit të pozicionit të Autoritetit për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve, në përputhje me politikën kombëtare të konkurrencës, normat dhe praktikatat më të mira të administratës publike, si dhe të së drejtës europiane të konkurrencës;

- Nxitjes së konkurrencës së lirë dhe mbrojtjes së konsumatorëve nëpërmjet ndërmarrjes së hetimit në tregun e importit dhe të shitjes me shumicë të sheqerit, të orizit, të shitjes me shumicë të vajit vegjetal, tregun e telekomunikacioneve, tregun e ngarkim-shkarkimit të GLN-së në rrugë detare etj.;

- Plotësimit dhe përmirësimit të kuadrit ligjor sekondar, duke reflektuar zhvillimet më të fundit të rregulloreve e praktikave më të mira të Bashkimit Europian, si dhe në përvojat tona;

- Rritjes së advokacisë dhe kulturës së konkurrencës nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë dhe interaktiv me entet rregullatore e institucionet qendrore, shoqatat e biznesit dhe ato të mbrojtjes së konsumatorit, por edhe me publikun e gjerë;

- Rritjes së bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare, për të forcuar rolin e Autoritetit në procesin e integritetit të vendit;

- Konsolidimit të shkallës së ekspertizës dhe të kapaciteteve administrative, që kanë ndihmuar në rritjen e shpejtësisë së veprimit, në përgjigje të ankesave dhe ndërtimit të taktikave në mënyrën e duhur, për të përmirësuar instrumentin e *down raids*-it;

- Rritjen e llojeve të tregjeve që kanë qenë objekt i monitorimit dhe i hetimeve, apo i kontrollit dhe vlerësimit të përqendrimit nga institucioni i konkurrencës.

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Konkurrencës për vitin 2012 të përmirësojë punën në këto drejtime:

- Plotësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kuadrit ligjor sekondar me rregullore dhe udhëzues, i cili ka ndikim të drejtpërdrejtë në forcimin e zbatimit të ligjit të konkurrencës, në përputhje me praktikatat e vendeve të tjera dhe direktivat e Bashkimit Europian, në veçanti për nxitjen e konsolidimit të instrumentit të ankesës së operatorëve të tregut;

- Përfundimin e hetimeve të nisura, si dhe zgjerimin e thellimit të hetimeve në tregje, për të eliminuar deformimet e konkurrencës dhe për të mbrojtur konsumatorët;

- Rritjen e efikasitetit të ndërhyrjeve në tregjet ku shfaqen shenjat e kufizimit të konkurrencës, nëpërmjet përsosjes së teknikave investigative, nëpërmjet rritjes profesionale të punonjësve të Autoritetit të Konkurrencës;

- Rritjen e kulturës për ligjin dhe politikën kombëtare të konkurrencës, duke promovuar partnerшипin dhe bashkëpunimin, kryesisht me komunitetin e biznesit;

- Ndërgjegjësimin e aktorëve të ndryshëm dhe publikut për rëndësinë e konkurrencës dhe rolin e Autoritetit në ruajtjen e saj, si dhe bashkëpunimin me ta në këtë proces;

- Rritjen e shpejtësisë së ndërhyrjeve në treg, nëpërmjet rritjes profesionale të punonjësve të Autoritetit të Konkurrencës;

- Forcimin e bashkëpunimit dhe ndërveprimit ndërinstitucional me entet rregullatore dhe institucionet e tjera publike.

Kuvendi i kërkon organeve ekzekutive të të gjitha niveleve të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës:

- Në dhënien dhe shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për monitorimin e tregut dhe hetimin e praktikave që deformojnë konkurrencën në treg;

- Për konsultime të përhershme në procesin e përgatitjes dhe miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore.

19 prill 2012

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)